



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1275/6 prot.

Datë 16.06.2026

V E N D I M
Nr. 810/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Medi Tel*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “*Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026*”, me fond limit 6,486,240 (*gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi pranimin e ankesës (nr.1275/2026, datë 27.04.2026 të operatorit ekonomik Vale Recycling shpk) për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Medi Tel*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “*Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026*”, me fond limit 6,486,240 (*gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Vale Recycling*” SHPK me NIPT L28029301Q me adresë: Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit, Kurbin.

Operatori ekonomik “*Medi Tel*” SHPK me NIPT J71519004Ë dhe me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. Pronësisë 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtar, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

I.2. Operatorët ekonomikë ankimues kane *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni konstaton, se

ankesat lidhen me të njëjtën procedurë prokurimi prandaj do të jenë objekt shqyrtimi në të njëjtin vendim.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.03.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “*Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026*”, me fond limit 6,486,240 (*gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II.2. Në datën 07.04.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar raportit të auditit, informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 08.04.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Medi Tel” shpk,	4.864.680	lekë	kualifikuar
2. “Vale Recycling” SHPK	6,351,110	lekë	kualifikuar

II.5. Në datën 08.04.2026, operatori ekonomik “*Medi Tel*” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.6. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 20.04.2026 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit

II.7. Në datën 25.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6585, protokolluar në datën 27.04.2026 me nr. 1275/2026 protokoli e operatorit ekonomik “*Vale Recycling*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “*Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026*”, me fond limit 6,486,240 (*gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Medi Tel*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, me arsyet si vijon:

Nga autoriteti kontraktor ne Dokumentat standarte te tenderit, ne Kriteret teknike pika 2.3.4. eshte kerkuar: Operatori duhet te ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi te njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 Për menaxhimin e integruar te mbetjeve, i ndryshuar, si dhe të VKM-se per miratimin e rregullores Për menaxhimin e mbetjeve spitalore, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, si më poshtë:

a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope

b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1

c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;

d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar pikës 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, operatori ekonomik duhet të provojë se disponon impiante dhe makineri specifike për përmbushjen e objektit të prokurimit, duke i pasqyruar ato në mënyrë të detajuar në formularin e vetëdeklarimit sipas te dhenave qe rezultojne ne lejen mjedisore përkatëse.

Në këtë kuadër, operatori ekonomik MEDI-TEL shpk, në formularin e vetëdeklarimit (Shtojca nr.10) ka deklaruar se disponon pajisjen ECODAS për trajtim me sterilizim (autoklavë) dhe se kjo pajisje është e përfshirë në lejen PN-4737-03-2017, me kodin III.1.B nenkategoria Leje Mjedisore Tip B, me akt miratimi nr.2959 prot., date 13.04.2018, nr. i identifikimi i lejes 2533/1, e cila duhet të jetë pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës. Nga shqyrtimi i kësaj leje mjedisore e cila eshte e aksesueshme dhe online ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit, ëëë.qkb.gov.al, rezulton qartazi se:

- Emri i pajisjes ECODAS nuk është i deklaruar askund në lejen Tip B.

- Nuk ka asnjë përmendje të identifikueshme të markës, modelit, numrit serial apo të dhëna të tjera për ndonjë pajisje konkrete.

- Në përshkrimin teknik flitet në mënyrë të përgjithshme për teknologji autoklavimi, pa identitet të veçantë të ndonjë impianti real. Ky fakt është thelbësor dhe përbën deklaram të rremë, pasi:

- Deklarimi në formularin e vetëdeklarimit është në kundërshtim me të dhënat e dokumentit ligjor përkatës, pra me lejen mjedisore të sipercituar;

- Në këtë mënyrë, operatori është vetëdeklaruar në mënyrë të pavërtetë, duke pretenduar përmbushjen e një kriteri të detyrueshëm me një pajisje që nuk e ka të deklaruar në lejen mjedisore. Operatori MEDI-TEL shpk ka paraqitur një vetëdeklarim të rremë, duke pretenduar se pajisja ECODAS është e përfshirë në lejen mjedisore, ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë dhe mund të verifikohet publikisht në faqen e QKB dhe aktet e AKM. Ky veprim përbën shkelje serioze të integritetit të procedurës, duke cenuar konkurrencën, barazinë në garë dhe besueshmërinë e sistemit të prokurimeve publike. Operatori ekonomik MEDI-TEL sh.p.k. nuk duhej të kualifikohej, pasi impianti i sterilizimit/autoklavimit i deklaruar prej tij nuk rezulton i pasqyruar në akt-miratimin mjedisor përkatës. Ky operator ka pretenduar se disponon pajisjen ECODAS dhe se ajo është e përfshirë në lejen mjedisore Tip B me nr. PN-4737-03-2017, të shoqëruar me Akt Miratimi nr. 2533/1, datë 13.04.2018. Megjithatë, nga shqyrtimi i kësaj lejeje dhe akt-miratimit rezulton se emri i pajisjes ECODAS nuk figuron askund, nuk pasqyrohet marka, modeli, numri serial apo ndonjë element tjetër individualizues i impiantit konkret, por vetëm një përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së përdorur. Për rrjedhojë, pajisja konkrete e deklaruar nga operatori ekonomik nuk rezulton e pasqyruar në aktin administrativ përkatës, ashtu siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

Kjo mangësi nuk është një çështje e re apo e paqartë, pasi është konstatuar më parë edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 1126/2025, datë 26.08.2025, ku pas një hetimi administrativ të plotë dhe verifikimeve pranë autoriteteve kompetente është evidentuar se impianti i sterilizimit/autoklavimit i deklaruar nga MEDI-TEL sh.p.k. nuk rezultonte i pasqyruar në akt-miratimet përkatëse. Për sa kohë që pas këtij vendimi operatori ekonomik nuk ka ndryshuar asnjë leje mjedisore dhe nuk ka shtuar asnjë impiant në to, gjendja faktike dhe dokumentare mbetet e pandryshuar edhe në procedurën aktuale. Rëndësia e kësaj mangësie del edhe më qartë nga rruga procedurale dhe hetimi administrativ i ndjekur nga KPP në vendimin nr. 1126/2025. Konkretisht, KPP i ka kërkuar autoritetit kontraktor dokumentacionin e plotë shoqërues të akteve të miratimit për licencat përkatëse dhe, më tej, i është drejtuar drejtpërdrejt Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me kërkesë për informacion zyrtar lidhur me lejen e mjedisit Tip B nr. PN-4737-03-2017, Akt Miratimin nr. 2533/1, datë 13.04.2018, si dhe licencën III.2.B dhe aktin e saj të miratimit. Pas administrimit të këtij informacioni dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga MEDI-TEL, KPP arriti në përfundimin e qartë se në asnjë rubrikë të këtyre akteve nuk ishte pasqyruar se për metodën e trajtimit me sterilizim/autoklavim ishte i instaluar impianti konkret i deklaruar nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit. Pra, KPP ka konstatuar shprehimisht se aktet administrative përkatëse nuk individualizonin impiantin e autoklavimit të deklaruar nga MEDITEL. Po aq i rëndësishëm është fakti se ky përfundim i KPP-së nuk është mbështetur mbi një vlerësim formal, por mbi analizën e kombinuar të kriterit 2.3.4, të argumentimit të bërë nga vetë autoriteti kontraktor për këtë kriter, të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik dhe të informacionit zyrtar të siguruar nga AKM. Vetë autoriteti kontraktor ka theksuar në argumentimin e kriterit se pasqyrimi i pajisjeve në akt-miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vërteton se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve dhe se fokusi i kësaj kërkesë është pikërisht tek impianti. Për këtë arsye, mungesa e pasqyrit të impiantit konkret nuk përbën thjesht një mangësi formale, por cenon vetë substancën e kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor. Ky precedent ka vlerë të drejtpërdrejtë edhe për procedurën aktuale, pasi operatori ekonomik MEDI-

TEL sh.p.k. rezulton i kualifikuar dhe i shpallur fitues, ndonëse pas vendimit nr. 1126/2025, datë 26.08.2025, ai nuk ka ndryshuar asnjë leje mjedisore dhe nuk ka shtuar asnjë impiant në to. Në këto kushte, përderisa gjendja juridike dhe dokumentare e lejeve dhe licencave të këtij operatori mbetet e pandryshuar, atëherë edhe përfundimi duhet të mbetet i njëjtë: operatori nuk provon që impianti konkret i autoklavimit është i pasqyruar në akt-miratimet përkatëse, ashtu siç kërkohet shprehimisht nga kriteri 2.3.4 i dokumenteve të tenderit. Për pasojë, kualifikimi i tij në procedurën aktuale është në kundërshtim të hapur me dokumentet e tenderit dhe me standardin e verifikimit të vendosur tashmë nga KPP pas një hetimi të plotë administrativ pranë organeve kompetente. Përveç sa është parashtruar më sipër, mospasqyrimi i impiantit konkret në lejen dhe akt-miratimin mjedisor prodhon jo vetëm pasoja juridike në procedurën e prokurimit, por edhe pasoja të drejtpërdrejta mjedisore në mënyrën e trajtimit të mbetjeve.

Pasojat juridike janë si më poshtë:

1. Mosprovimi i përmbushjes së kriterit 2.3.4 të dokumenteve të tenderit, pasi operatori ekonomik nuk vërteton se impianti konkret i deklaruar prej tij është pikërisht ai që rezulton i miratuar nga organi kompetent mjedisor.
2. Mungesa e provës për autorizimin ligjor të impiantit konkret, pasi në mungesë të pasqyrimin të tij në lejen dhe akt-miratimin përkatës, nuk provohet që pajisja konkrete me të cilën pretendohet realizimi i kontratës është e licencuar dhe e lejuar për trajtimin e mbetjeve objekt prokurimi.
3. Pavërtetësia e vetëdeklarimit për këtë element të kualifikimit, për sa kohë deklarimi i operatorit ekonomik nuk përputhet me përmbajtjen e dokumentacionit administrativ përkatës, konkretisht me lejen dhe akt-miratimin mjedisor ku ai pretendon se impianti është i përfshirë.
4. Cenimi i vetë substancës së kriterit të kualifikimit, pasi vetë autoriteti kontraktor ka kërkuar që pajisjet të jenë të pasqyruara në akt-miratimet përkatëse, pikërisht për të provuar se impiantet konkrete janë të autorizuar për procesin e trajtimit të mbetjeve. Në këto kushte, mungesa e këtij pasqyrimi nuk është një mangësi formale, por materiale dhe thelbësore.
5. Shkak i drejtpërdrejtë për skualifikim, për sa kohë operatori ekonomik nuk provon përmbushjen e kriterit 2.3.4 sipas mënyrës së kërkuar nga dokumentet e tenderit dhe sipas interpretimit të dhënë edhe nga vetë KPP në vendimin nr. 1126/2025.
6. Shkak për raportim pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, nëse konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur si të përfshirë në aktet mjedisore një impiant konkret që në fakt nuk rezulton i pasqyruar në to, situatë e cila bie në fushën e nenit 76, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik.
7. Cenimi i parimit të trajtimit të barabartë dhe i integritetit të procedurës, pasi pranimi në garë dhe shpallja fitues e një operatori që nuk provon impiantin konkret sipas kërkesës së DST-së deformon standardin e verifikimit dhe dëmton besueshmërinë e procedurës së prokurimit.

Pasojat mjedisore janë si më poshtë:

1. Mungesa e garancisë për trajtimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme spitalore, pasi nuk provohet që impianti konkret me të cilin pretendohet realizimi i kontratës është pikërisht ai që është miratuar nga organi kompetent për këtë proces.
2. Rritja e rrezikut të ndotjes së mjedisit, për shkak se mungon siguria ligjore dhe teknike që trajtimi i mbetjeve kryhet me pajisje të verifikuara dhe të autorizuar sipas kushteve mjedisore të vendosura nga organi kompetent.

3. Cenimi i sigurisë sanitare dhe i shëndetit publik, pasi trajtimi i mbetjeve spitalore me një impiant të pëcaktuar dhe identifikuar në aktet mjedisore rrit rrezikun e kontaminimit, të përhapjes së agjentëve infektivë dhe të ekspozimit të personelit, publikut dhe mjedisit ndaj rreziqeve biologjike.

4. Mungesa e kontrollit efektiv dhe e gjurmueshmërisë së procesit, pasi pa pasqyrimin e impiantit konkret në leje dhe akt-miratim, autoritetet mbikëqyrëse nuk kanë garanci të plotë se trajtimi kryhet realisht me pajisjen që duhet të ishte objekt i miratimit dhe i kontrollit mjedisor.

5. Cenimi i përputhshmërisë me kushtet dhe standardet mjedisore të miratuara, pasi nuk provohet që pajisja konkrete përmbush parametrat teknikë, kapacitetet dhe kushtet operative mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore.

6. Rreziku për menaxhim jo të sigurt të rrymave të mbetjeve, duke vënë në dyshim vetë procesin e trajtimit, neutralizimit dhe asgjësimit përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe sanitar.

- Në konkluzion, kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik MEDI-TEL sh.p.k., për shkak se nuk provon përmbushjen e kriterit 2.3.4 të dokumenteve të tenderit, pasi impianti konkret i sterilizimit/autoklavimit i deklaruar prej tij nuk rezulton i pasqyruar në akt-miratimet mjedisore përkatëse, ndryshe nga sa kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

- Gjithashtu, për sa kohë që në rastin konkret rezulton paraqitja e të dhënave të pavërteta për qëllime kualifikimi, kërkojmë që, krahas skualifikimit të operatorit ekonomik MEDITEL sh.p.k., autoriteti kontraktor të procedojë edhe me raportimin e këtij rasti pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 76, pika 5, të ligjit nr. 162/2020.

II.8. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1275/1 prot., datë 28.04.2026, janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat ngre pretendime ankimesi “Vale Recycling” SHPK, i cili kundërshton me anë të ankesës me nr. 1275/2026 prot., datë 27.04.2026.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 1275/2 prot, datë 30.04.2026, nga operatori ekonomik i interesuar “Medi Tel” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.10. Me shkresën nr. 1431/8 prot, datë 05.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1275/3 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar aktin e trajtimit të ankesës nr. 1431/7 prot, datë 05.05.2026 të operatorit ekonomik ankimesi “Vale Recycling” SHPK, ku me vendimin nr. 69/2026 prot, datë 05.05.2026, ka vendosur pranimin e ankesës nr. 1275/2026 prot, datë 27.04.2026, të operatorit ekonomik ankimesi si më poshtë vijon:

Lidhur me pretendimin e ankimesit se “... Nga shqyrtimi i lijes mjedisore e cila është e aksesueshme dhe online në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ëëë.qkb.gov.al, rezulton qartazi se emri ipajisjes ECODAS nuk është i deklaruar askund në lejen e Tipit B...”,

KSHA konstaton se: Në lidhje me kriterin kualifikues të përcaktuar në Dokumentat e Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.4, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “Medi tel” shpk ka dorëzuar shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në Seksionin B Pjesa III Kriteret e Perzgjedhjes/Kualifikimit ka deklaruar si vijon: “XXX -Primar -Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) - 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet”; ku per metoden e trajtimit t mbetjeve spitalore me “Autoklavim” disponon pajisjen e autoklavimit model “XXX” (pajisje e cila eshte primare) dhe se per kete metode eshte i pajisur me Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) dhe Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) që perfshin kodet si ne vijim: “18 01 01 -Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet”; duke e plotsuar kete kriter kualifikues. Ndërkohe nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e Operatorit ekonomik ofertues ‘MEDI-TEL’ shpk, KSHA konstaton se per permbushje të deklarimeve të bera më sipër, ky operator ekonomik ofertues ka paraqitur Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numer: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit per shoqërine “MEDI-TEL” shpk, shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” nr. 2533/1, date 13.04.2018, leshuar nga Agjencia Kombetare e Medisit, si dhe License me kodin: III.2.B, me numer: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit per shoqerine “MEDI-TEL” shpk, me emertimin pershkrues te veprimtarise: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve te rrezikshme spitalore”, shoqëruar me Akt Miratimi ‘Licensë e kategorise III.2.B” Nr. 367, date 08.11.2019, leshuar nga Agjencia Kombetare e Medisit, per subjektin “MEDI-TEL” shpk (LC-4716) me Titull Instalimi: ‘Menaxhim i mbetjeve”, me aktivitet te licensuar: ‘Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve te rrezikshme spitalore”, ku nga shqyrtimi i Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” Nr. 2533/1, date 13.04.2018, leshuar nga Agjencia Kombetare e Medisit dhe Akt Miratimi “License e kategorise III.2.B” Nr. 367, datë 08.11.2019, lëshuar nga Agjencia Kombetare e Medisit, per subjektin “MEDI-TEL” shpk konstatohet se në asnje rubrikë te këtyre akteve të miratimit nuk është pasqyruar që per metoden e trajtimit të mbetjeve spitalore me “Autoklavim” te jete i instaluar impianti per trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “XXX”, sikurse ka deklaruar ky operator ekonomik ofertues në fazën e ofertimit.

KSHA pas verifikimeve konstaton se ky dokumentacion i paraqitur eshte i njejte me dokumentacionin e paraqitur per proceduren e prokurimit me objekt: “Evadim, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldine” Tirane”, me Nr. REF 49235-05-27-2025, zhvilluar më date 27.06.2025 nga Operatori i Blerjeve te Përgendruara sh.a, ku Komisioni i Prokurimit Publik nëpermjet Vendimit me Nr. 1126/2025 date 26.08.2025 eshte shprehur ne lidhje me keto pretendime. Konkretisht ne piken III.2.16, te Vendimit të sipercituar, KPP ndër të tjera ka gjykuar se: “... Për më tepër, referuar shkresës nr. 8804/1 prot, date 20.08.2025, te Agjencise Kombetare te Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1944/12 prot, date 22.08.2025, Komisioni konstaton aktel e miratimit janë sipas formatit

të miratuar me VKM-në Nr. 419, datë 25.6.2014 “Per miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”, e ndryshuar dhe VKM-së Nr.538, datë 26.5.2009 “Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të perbashketa”, e ndryshuar, dhe se këto akte përmbajnë pershkrimin e veprimtarisë sipas vetdeklarimeve të subjekteve, ku në rastin konkret subjekti për të cilin janë miratuar këto akte nuk ka deklaruar llojin, modelin dhe kapacitetin e impiantit për traktimin e metjeve spitalore me metodën Autoklavim. Përsa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimes, argumentimit të kriterit kualifikues dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues ‘MEDI TEL’ SHPK, Komisioni gjykon se ky i fundit nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në Akt Miratimin “Leje Medisi Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe në Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367, datë 08.11.2019, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për subjektin nuk evidentohet se për metodën e trajtimit të metjeve spitalore me “Autoklavim” në këto akte të jetë e pasqyruar që ky subjekt ka të instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “ECODAS T300”, duke mos plotësuar kushtin e katër kumulativ të përmendur në pikën III.2.15. të këtij vendimi dhe për më tepër në përgjigjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SHA referuar shkresës nr. 1661/8 prot., datë 29.30.2025, protokolluar me tonën me nr.1944/3 prot., datë 30.07.2025 ku evidenton si në vijim: “Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, “Medi-Tel” shpk konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur dokumentacionin që zotëron mjetet e kërkuara, të dhënat teknike si dhe pasqyrimin e tyre në aktet e miratimeve të lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për lejet dhe licensat”, nuk evidentohet se në cilën rubrikë të akt miratimeve të sipërpërmendura është pasqyruar instalimi i impiantit për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “XXX”. Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “V.A.L.E RECYCLING” shpk, për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “MEDI – TEL” shpk qëndron.

Përsa më sipër, referuar pretendimit të ankimesit; argumentimit të kriterit kualifikues; argumentimit të paraqitur nga OE “MEDI – TEL” shpk (ku nëpërmjet Formularit të argumentave nuk ka argumentuar apo provuar të kundërtën në lidhje me pretendimin e ankimesit) si dhe referuar dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “MEDI – TEL” shpk, (nga ku konstatohet se ky dokumentacion është i njëjte me dokumentacionin e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt: “Evadim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldine” Tiranë”, me Nr. REF 49235-05-27-2025, zhvilluar më datë 27.06.2025 nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sha.), KSHA gjykon se ky i fundit nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik, Kriterete Veçanta të Kualifikimit, të dokumenteve të tenderit,

pasi në Akt Miratimin “Leje Mjedisore Tipi B” Nr. 2533/1, datë 13.04.2018, leshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe në Akt Miratimi “Licensë e kategorise III.2.B” Nr. 367, datë 08.11.2019, leshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për subjektin nuk evidentohet se për metodën e trajtimit të metjeve spitalore me “Autoklavim” në këto akte të jete e pasqyruar që ky subjekt ka të instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “ECODAS T300”.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për Këto Arsye

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenin 102 të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

Vendosi

- 1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomike të interesar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.*

II.11. Në datën 12.05.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2026/6643, datë 12.05.2026 dhe me nr. 1459/2026 prot, datë 12.05.2026, e operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK, me anë të së cilës kundërshton vendimin nr. 69/2026, datë 05.05.2026, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, për pranimin e ankesës nr. 1257/2026 prot, datë 27.04.2026 të operatorit ekonomik ankimues “Vale Recycling” SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK në këtë procedurë prokurimi objekt – shqyrtimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

Duke mos qene dakort me vendimarrjen e KSHA i drejtohem KPP me kete ankese. KSHA ka arsyetur në lidhje me pranimin e plotë të ankesës se: Në lidhje me kriterin kualifikues të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, Komisioni Shqyrtimit të Ankesave konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues MEDI-TEL shpk ka dorëzuar Shtojcën 10 Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit, ku në Seksionin B Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit ka deklaruar si vijon: XXX -Primar -Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) Licence III 2 B (Për trajtimin e mbetjeve

te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) - 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (perveç 18 01 03): 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave kërkon trajtim te veçantë per te parandaluar infeksionet;; ku per metoden e trajtimit te mbetjeve spitalore me Autoklavim disponon pajisjen e autoklavimit model XXX (pajisje e cila eshte primare) dhe se per këte metode është i pajisur me Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) dhe Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) që perfshin kodet si në vijim: 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (perveç 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave kërkon trajtim te veçantë per te parandaluar infeksionet;; duke e plotësuar këte kriter kualifikues. Ndërkohe nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues MEDI-TEL shpk, KSHA konstaton se për permbushje te deklarimeve te bëra më siper, ky operator ekonomik ofertues ka paraqitur Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit per shoqërinë MEDI-TEL shpk, shoqëruar me Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B nr. 2533/1, date 13.04.2018, leshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si dhe License me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit per shoqërinë MEDI-TEL shpk, me emertimin pershkruar të veprimtarise: Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme spitalore shoqëruar me Akt Miratimi License e kategorise III.2.B Nr. 367, date 08.11.2019, lëshuar nga Agjencia Kombetare e Medisit, per subjektin MEDI-TEL shpk (LC-4716) me Titull Instalimi: Menaxhim i mbetjeve, me aktivitet te licensuar: Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme spitalore, ku nga shqyrtimi i Akt Miratimi Leje Mjedisit Tipi B Nr. 2533/1, date 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe Akt Miratimi License e kategorise III.2.B Nr. 367, datë 08.11.2019, leshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, per subjektin MEDI-TEL shpk konstatohet se në asnjë rubrikë te këtyre akteve te miratimit nuk është pasqyruar që per metoden e trajtimit te mbetjeve spitalore me Autoklavim te jete i instaluar impianti por trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit XXX , sikurse ka deklaruar ky operator ekonomik ofertues në fazën e ofertimit. KSHA pas verifikimeve konstaton se ky dokumentacion i paraqitur është i njejte me dokumentacionin e paraqitur per proceduren e prokurimit me objekt: Evadim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj Mbretëresha Geraldine Tirane, me Nr. REF 49235-05-27-2025, zhvilluar më date 27.06.2025 nga Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a, ku Komisioni i Prokurimit Publik nepermjet Vendimit me Nr. 1126/2025 date 26.08.2025 është shprehur në lidhje me këto pretendime.

Konkretisht në pikën III.2.16, te Vendimit të sipercituar, KPP ndër të tjera ka gjykuar se: ... Per më teper, referuar shkreses nr. 8804/1 prot, datë 20.08.2025, te Agjencise Kombëtare te Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1944/12 prot, date 22.08.2025, Komisioni konstaton aktet e miratimit jane sipas formatit te miratuar me VKM-në Nr. 419, date 25.6.2014 Per miratimin llojin, modelin dhe kapacitetin e impiantit për trajtimin e mbetjeve spitalore me metoden Autoklavim. Persa më siper, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues argumentimit të kriterit kualifikues dhe dokumentacionit fizik te dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues MEDI TEL SHPK, Komisioni gjykon se ky i fundit nuk e ploteson kriterin kualifikues të percaktuar në pikën 2.3.4 Kapaciteti teknik te shtojces 9 Formulari i Kriteve te Perzgjedhjes/Kualifikimit te dokumenteve te tenderit, te procedurës së prokurimit objekt

ankimi, pasi në Akt Miratimin Leje Mjedisit Tipi B nr. 2533/1, date 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe në Akt Miratimi License e kategorise III.2.B nr. 367, datë 08.11.2019, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, per subjektin nuk evidentohet se per metoden e trajtimit të mbetjeve spitalore me Autoklavim në këto akte te jetë e pasqyruar që ky subjekt ka te instaluar impianti per trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit ECODAS T300, duke mos plotesuar kushtin e katër kumulativ të permendur në pikën III.2.15. të ketij vendimi dhe per me tepër ne pergjigjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Perqëndruara SH.A referuar shkreses nr. 1661/8 prot., date 29.30.2025, protokolluar me tonën me nr. 1944/3 prot., date 30.07.2025 ku evidenton si në vijim: Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, Medi-Tel shpk konstaton se ky i fundit, ne permbushje te kriterit të sipercituar, ka paraqitur dokumentacionin që zotëron mjetet e kerkuara, te dhënat teknike si dhe pasqyrimin e tyre në aktet e miratimeve të lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, per lejet dhe licensat, nuk evedentohet se në cilën rubrikë te akt miratimeve te siperpërmendura eshte pasqyruar instalimi etj. Konkluzionet e arritura nga KSHA sipas vendimit të sipërcitura janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe ti i tillë duhet të shfuqizohet.

Sqarojmë KPP se nga ana jonë në përmbushje të kushteve të kërkuara kemi paraqitur edhe Vërtetimin e datës 22.12.2025 të ISHTI, ngarkuar në sistemin e APP Vertetim per enet nen presion Medi Tel e cila ka vërtetuar se shoqëria jonë ka të regjistruara si pajisje nën presion ndër të tjera 1-Autoklavë ECODAS T-300 etj. Leja mjedisore përkatesë del në bazë të pasjisjeve të regjistruara konkretisht në rastin konkret për pajisjen ECODAS për trajtim me sterilizim (autoklavë) dhe se kjo pajisje është e përfshirë në lejen PN-4737-03-2017, me kodin III.1.B nënkategoria Leje Mjedisore Tip B, me akt miratimi nr. 2959/1 prot., date 13.04.2018, nr. i identifikimi i lejes 2533/1, e cila është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës. Ky vërtetim është marrë nga ana jonë pranë ISHTI pas shkresës kthim përgjigje të AKM e cila me anë të shkresës Nr.9536/1 Prot datë 11.09.2025. Ky vërtetim nuk ka qënë pjesë e shqyrtimit të ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: Evadim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore në S.U.O.Gj Mbretëresha Geraldine Tirane , me Nr. REF 49235-05-27-2025, ku Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë Vendimi me Nr. 1126/2025 date 26.08.2025,

Sa sipër me dokumentacionin e paraqitur nga ana jo

Për të gjitha sa më sipër kërkojmë:

1. Shfuqizimin e vendimit KSHA 69/2026 datë 05.05.2026 që ka vendosur skualifikimin e Shoqerise Medi_Tel shpk.
2. Rrëzimin/mospranimin e ankesës së paraqitur nga Vale Recycling SHPK me NIPT L28029301Q për procedurën e prokurimit publik Procedurë e hapur, e thjeshtuar , me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026.
3. Kualifikimin e operatorit Medi-tel shpk dhe vijim e procedurave per lidhjen e kontratës me objekt Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1459/1 prot., datë 13.05.2026, është publikuar pretendimi i ankimesit në lidhje me vendimarrjen e KSHA-së.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 1459/2 prot, datë 19.05.2026, nga operatori ekonomik i interesuar “*Vale Recycling*” SHPK, sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

II.14. Me shkresën nr. 1459/3 prot., datë 05.06.2026 me objekt “*Kërkesë për informacion*” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit informacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik “MEDI – TEL” SHPK me numër NIPT-i: M12406021M është i pajisur me lejet dhe licensat si më poshtë:

- *Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Leje mjedisi e tipi B për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1a) ose lëndfillimit (5.2a)”, shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, me numër protokoll nr. 2959 prot, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-7608).*
- *Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.”, shoqëruar me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. Identifikimi: 367, me numër protokoll nr. 9561 prot, datë 08.11.2019, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4716).*

Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

1. *Cili është modeli dhe marka e pajisjes të instaluar, për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore të instaluar në vendin e ushtrimit të aktivitetit të subjektit “MEDI-TEL” SHPK, për të cilën është miratuar leja e mjedisit nga ana e institucionit tuaj me Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, me numër protokoll nr. 2959 prot, datë 13.04.2018?*
2. *Cili është modeli dhe marka e pajisjes të instaluar, për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore në vendin e ushtrimit të aktivitetit të subjektit “MEDI-TEL”*

SHPK, për të cilën është miratuar licenca nga ana e institucionit tuaj me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. Identifikimi: 367, me numër protokolli nr. 9561 prot, datë 08.11.2019?

- 3. A është detyrim ligjore që në Akt Miratimin “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, me numër protokolli nr. 2959 prot, datë 13.04.2018, të pasqyrohet modeli dhe marka e pajisjes të instaluar, për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 419 datë 25.06.2014 “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A DHE B, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-ja”, i ndryshuar, që ka qënë në fuqi në kohën e lëshimit të këtij akti miratimi?*
- 4. A është detyrim ligjor që në Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. Identifikimi: 367, me numër protokolli nr. 9561 prot, datë 08.11.2019, të pasqyrohet modeli dhe marka e pajisjes të instaluar, për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore?*

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik kërkojmë që të na vini në dispozicion informacionin e sipërkërkuar brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

II.15. Me shkresën nr. 8925/1 prot, datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1459/4 prot, datë 12.06.2026, me objekt “Kthim përgjigje kërkesës për informacion” është depozituar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit pranë Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni me përmbajtje si më poshtë:

Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 1459/3 prot, datë 05.06.2026, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Nr. 8925 prot, datë 08.06.2026, me lëndë “Kërkesë për informacion për subjektin Medi Tel”, ju bëjmë me dije se:

Nga verifikimet për subjektin “Medi Tel” me NUIS J71519004Ë, rezultojnë të publikuara në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave pranë QKB-së:

- Leje e mjedisit e tipit B, me PN-4737-03-2017, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Asgjësimi I mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2 a), vendi i kryerjes së veprimtarisë; Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. Pronësie 41/1/16/2 me Akt Miratimi Nr. 2959 Prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11, ku janë të pasqyruara të gjitha të dhënat e instalimit, për veprimtrainë, proceset, metodat dhe kapacitetin.*

- *Licencë e nënkategorisë me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, vendi i kryerjes së veprimtarisë: Tiranë, Autostrada Tiranë Durrës, Km.1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zonë Kadastrale Nr. 2679, Nr. pronësisë 41/1/16/2, me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45, ku janë të pasqyruara lloji i mbetjeve për grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim deri në asgjësim.*

Bashkëlidhur shkresës gjeni kopje të lejes së mjedisit me PN-4737-03-2017, Akt Miratimi Nr. 2959 prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11 dhe Licencës me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019 me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E RECYCLING” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Medi - Tel” SHPK, me arsyen se: *Nga autoriteti kontraktor ne Dokumentat standarte te tenderit, ne Kriteret teknike pika 2.3.4. eshte kerkuar: Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi te njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 Për menaxhimin e integruar te mbetjeve, i ndryshuar, si dhe të VKM-se per miratimin e rregullores Për menaxhimin e mbetjeve spitalore, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, si më poshtë:*

a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope

b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1

c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;

d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të

paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar pikës 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, operatori ekonomik duhet të provojë se disponon impiante dhe makineri specifike për përmbushjen e objektit të prokurimit, duke i pasqyruar ato në mënyrë të detajuar në formularin e vetdeklarimit sipas të dhënave që rezultojnë në lejen mjedisore përkatëse.

Në këtë kuadër, operatori ekonomik MEDI-TEL shpk, në formularin e vetdeklarimit (Shtojca nr.10) ka deklaruar se disponon pajisjen ECODAS për trajtim me sterilizim (autoklavë) dhe se kjo pajisje është e përfshirë në lejen PN-4737-03-2017, me kodin III.1.B nënkategoria Leje Mjedisore Tip B, me akt miratimi nr.2959 prot., datë 13.04.2018, nr. i identifikimi i lejes 2533/1, e cila duhet të jetë pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës. Nga shqyrtimi i kësaj leje mjedisore e cila është e aksesueshme dhe online në faqen zyrtare të Qendres Kombëtare të Biznesit, ëëë.qkb.gov.al, rezultojnë qartazi se:

- Emri i pajisjes ECODAS nuk është i deklaruar askund në lejen Tip B.
- Nuk ka asnjë përmendje të identifikueshme të markës, modelit, numrit serial apo të dhëna të tjera për ndonjë pajisje konkrete.
- Në përshkrimin teknik flitet në mënyrë të përgjithshme për teknologji autoklavimi, pa identitet të veçantë të ndonjë impianti real. Ky fakt është thelbësor dhe përbën deklaram të rremë, pasi:
- Deklarimi në formularin e vetdeklarimit është në kundërshtim me të dhënat e dokumentit ligjor përkatës, pra me lejen mjedisore të sipercituar;
- Në këtë mënyrë, operatori është vetdeklaruar në mënyrë të pavërtetë, duke pretenduar përmbushjen e një kriteri të detyrueshëm me një pajisje që nuk e ka të deklaruar në lejen mjedisore. Operatori MEDI-TEL shpk ka paraqitur një vetdeklarim të rremë, duke pretenduar se pajisja ECODAS është e përfshirë në lejen mjedisore, ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë dhe mund të verifikohet publikisht në faqen e QKB dhe aktet e AKM. Ky veprim përbën shkelje serioze të integritetit të procedurës, duke cenuar konkurrencën, barazinë në garë dhe besueshmërinë e sistemit të prokurimeve publike. Operatori ekonomik MEDI-TEL sh.p.k. nuk duhet të kualifikohet, pasi impianti i sterilizimit/autoklavimit i deklaruar prej tij nuk rezultojnë i pasqyruar në akt-miratimin mjedisor përkatës. Ky operator ka pretenduar se disponon pajisjen ECODAS dhe se ajo është e përfshirë në lejen mjedisore Tip B me nr. PN-4737-03-2017, të shoqëruar me Akt Miratimi nr. 2533/1, datë 13.04.2018. Megjithatë, nga shqyrtimi i kësaj lejeje dhe akt-miratimit rezultojnë se emri i pajisjes ECODAS nuk figuron askund, nuk pasqyrohet marka, modeli, numri serial apo ndonjë element tjetër individualizues i impiantit konkret, por vetëm një përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së përdorur. Për rrjedhojë, pajisja konkrete e deklaruar nga operatori ekonomik nuk rezultojnë e pasqyruar në aktin administrativ përkatës, ashtu siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit.

Kjo mangësi nuk është një çështje e re apo e paqartë, pasi është konstatuar më parë edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 1126/2025, datë 26.08.2025, ku pas një hetimi administrativ të plotë dhe verifikimeve pranë autoriteteve kompetente është evidentuar se impianti i sterilizimit/autoklavimit i deklaruar nga MEDI-TEL sh.p.k. nuk rezultonte i pasqyruar në akt-miratimet përkatëse. Për sa kohë që pas këtij vendimi operatori ekonomik nuk ka ndryshuar asnjë leje mjedisore dhe nuk ka shtuar asnjë impiant në to, gjendja faktike dhe dokumentare mbetet e pandryshuar edhe në procedurën aktuale. Rëndësia e kësaj

mangësie del edhe më qartë nga rruga procedurale dhe hetimi administrativ i ndjekur nga KPP në vendimin nr. 1126/2025. Konkretisht, KPP i ka kërkuar autoritetit kontraktor dokumentacionin e plotë shoqërues të akteve të miratimit për licencat përkatëse dhe, më tej, i është drejtuar drejtpërdrejt Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me kërkesë për informacion zyrtar lidhur me lejen e mjedisit Tip B nr. PN-4737-03-2017, Akt Miratimit nr. 2533/1, datë 13.04.2018, si dhe licencën III.2.B dhe aktin e saj të miratimit. Pas administrimit të këtij informacioni dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga MEDI-TEL, KPP arriti në përfundimin e qartë se në asnjë rubrikë të këtyre akteve nuk ishte pasqyruar se për metodën e trajtimit me sterilizim/autoklavim ishte i instaluar impianti konkret i deklaruar nga operatori ekonomik në fazën e ofertimit. Pra, KPP ka konstatuar shprehimisht se aktet administrative përkatëse nuk individualizonin impiantin e autoklavimit të deklaruar nga MEDITEL. Po aq i rëndësishëm është fakti se ky përfundim i KPP-së nuk është mbështetur mbi një vlerësim formal, por mbi analizën e kombinuar të kriterit 2.3.4, të argumentimit të bërë nga vetë autoriteti kontraktor për këtë kriter, të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik dhe të informacionit zyrtar të siguruar nga AKM. Vetë autoriteti kontraktor ka theksuar në argumentimin e kriterit se pasqyrimi i pajisjeve në akt-miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vërteton se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve dhe se fokusi i kësaj kërkesë është pikërisht tek impianti. Për këtë arsye, mungesa e pasqyrit të impiantit konkret nuk përbën thjesht një mangësi formale, por cenon vetë substancën e kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor. Ky precedent ka vlerë të drejtpërdrejtë edhe për procedurën aktuale, pasi operatori ekonomik MEDI-TEL sh.p.k. rezulton i kualifikuar dhe i shpallur fitues, ndonëse pas vendimit nr. 1126/2025, datë 26.08.2025, ai nuk ka ndryshuar asnjë leje mjedisore dhe nuk ka shtuar asnjë impiant në to. Në këto kushte, përderisa gjendja juridike dhe dokumentare e lejeve dhe licencave të këtij operatori mbetet e pandryshuar, atëherë edhe përfundimi duhet të mbetet i njëjtë: operatori nuk provon që impianti konkret i autoklavimit është i pasqyruar në akt-miratimet përkatëse, ashtu siç kërkohet shprehimisht nga kriteri 2.3.4 i dokumenteve të tenderit. Për pasojë, kualifikimi i tij në procedurën aktuale është në kundërshtim të hapur me dokumentet e tenderit dhe me standardin e verifikimit të vendosur tashmë nga KPP pas një hetimi të plotë administrativ pranë organeve kompetente. Përveç sa është parashtruar më sipër, mospasqyrimi i impiantit konkret në lejen dhe akt-miratimin mjedisor prodhon jo vetëm pasoja juridike në procedurën e prokurimit, por edhe pasoja të drejtpërdrejta mjedisore në mënyrën e trajtimit të mbetjeve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.3.4. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr.10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.3. Në procesverbalin e datës 24.03.2026 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A ka argumentuar vendosjen e kriteve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, impiantet për realizimin e trajtimit të kategorive të caktuara të mbetjeve spitalore, janë pajisjet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

Pasqyrimi në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 vërtetojnë se këto pajisje janë të licencuara për

realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e trete, ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e trete të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë, si dhe Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë provon përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

III.1.4. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.1.1 dhe 2.1.2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.1.1 Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, në VKM nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe në Termat e Referencës së DST (përveç incenerimit), ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,
si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 01** - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- **18 01 03** - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;
- **18 01 04** - Mbetjet e buta (grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për parandalimin e infeksioneve).

2.1.2 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit me Incenerim, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 02** - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

III.1.5. Në procesverbalin e datës 24.03.2026 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A ka argumentuar vendosjen e krieteve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", Udhëzuesi Kombëtar "Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore" dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore", Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar.

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "Medi-Tel" SHPK në fazën e ofertimit për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.1.1, 2.1.2 "Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë", dhe pikën 2.3.4 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9/2 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon, dokumentacion të cilin referuar kthim përgjigjes së AK dhe rubrikës kërkesa në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton ta ketë dorëzuar edhe pranë autoritetit kontraktor:

Për pikën 2.3.4 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9/2 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" të dokumenteve të tenderit Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

- Shtojcën 10 "FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT", i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë "MEDI-TEL" SHPK, ku në Seksionin B "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit" ka deklaruar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
------------------	------------------

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: ECODAS T300-Primar - Leje Mjedisore I 1 B (Tipi B)-Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim)- 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03): 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave kerkon traitim te vecante per te parandaluar infeksionet; ËFS-150 –Primar - Leje Mjedisore III 1C (Tipi A) - Licence III 2 B (Per trajtim dhe asgjësim i mbetjeve te rrezikshme me metoden incenerimit.) (Incenerim)- 18 01 02 - Pjese te trupit dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (perve 18 01 03); 18 01 08 – Medikamente citostatike dhe citotoksike, 18 01 09 – Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08. PI LVG 15 E -Primar -Leje Mjedisore III 1C (Tipi A) Paisja larese per kontenitoret shumeperdorimesh. AA511VC etj...
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Dokumentin e emërtuar “Autoklava_ECODAS (Pronesia_Leje-Karte_Teknologjike-CE)”, ku gjenden dokumentat e mëposhtëme:

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 11705, datë 19.03.2009, me eksportues shoqërinë franceze “ESODAS” SAS dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL”

SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Autoklav për trajtimin e mbetjeve”. (1 faqe)

- Deklaratë e lëshuar nga presidenti i kompanisë franceze “ECODAS” e datës 13 shkurt 2009, në gjuhën angleze, i cili deklaron si më poshtë vijon (1 faqe):

“
TO EHOM IT MAY CONCERN
Ëë, ECODAS located 28 rue Sébastopol 59100 - ROUBAIX - FRANCE hereby certifies that:
MEDITEL
LocatedrR Qemal Stafa Nr 51 - TIRANA - ALBANIA
Is authorized to treat medical ëaste in our machine ECODAS T300
Made in Roubaix - FRANCE, on February 13 2009.”.

- Deklaratë e lëshuar nga presidenti i kompanisë franceze “ECODAS” e datës 13 shkurt 2009, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar, i cili deklaron si më poshtë vijon (1 faqe):

“*ATIJ QË MUND T’I INTERËSOJË*
Ne, ECODAS E NDODHUR NË 28 ME Sebastopol 59100 – ROUBAIX – FRANCE vërteton se;
MEDITEL
E ndodhur në R Qemal Stafa Nrr 51 – Tiranë – Shqipëri është e autorizuar për të trajtuar mbetjet mjekësore në makinerinë tonë ECODAS T300 bërë në Roubaix – Francë, më 13 shkurt 2009
Firma, vula”.

- Dokumenti i emërtuar “ENGINEERED SOLUTIONS FOR HEALTH & THE ENVIRONMENT” i prodhuar nën autoritetin e shoqërisë “ECODAS”, në gjuhën angleze, ku jepen parametrat teknike, certifikimet dhe procesi teknologjik i pajisjeve “ECODAS T150”, “ECODAS T300”, “ECODAS T1000” dhe “ECODAS T2000”. (10 faqe)
- Dokumenti i emërtuar “ENGINEERED SOLUTIONS FOR HEALTH & THE ENVIRONMENT” i prodhuar nën autoritetin e shoqërisë “ECODAS”, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar ku jepen parametrat teknike, certifikimet dhe procesi teknologjik i pajisjeve “ECODAS T150”, “ECODAS T300”, “ECODAS T1000” dhe “ECODAS T2000”. (6 faqe)
- Certifikatë “QUALITY ASSURANCE SYSTEM acc. to Directive 2014/68/EU” me numër no: 01 202 F/Q-05 20176.00, datë 11.07.2023, në gjuhën angleze, e lëshuar nga trupa e njoftuar “TUV Rheinland Industrie Service” GmbH, për prodhuesin “ECODAS”, e cila vërteton se: “Hereëith ëë certify that the above-mentioned manufacturer operates a quality system according to the European Directive 2014/68/EU. The manufacturer has the permission to affix the folloëing CE marking to

pressure equipment described and manufactured in accordance to the scope covered by Quality-Assurance System: C€ 0035”, sipas testimit bazik: “Directive 2014/68/EU: QA-System (Module H1)” referuar raportit të auditit me numër no: 01 202 F/Q-05 20176, ku qëllimi është: “Sterilization machines for infectious waste of type ECODAS T100-T150-T300-T700-T1000-T2000 Boilers VE40k€-VE80k€, see annex to certificate: 01 202 F/Q-05 20176, revision 4 from 12/04/2023”, e vlefshme deri në datë 31.05.2026. (1 faqe)

- Certifikatë “Sistemi i Sigurimit të Cilësisë sipas Direktivës 2014/68/EU” me numër no: 01 202 F/Q-05 20176.00, datë 11.07.2023, e përkthyer dhe e noterizuar nga dokumenti origjinal në gjuhën angleze, e lëshuar nga trupa e njoftuar “TUV Rheinland Industrie Service” GmbH, për prodhuesin “ECODAS”, e cila vërteton se: “Me këtë, ne vërtetojme se prodhuesi i lartëpërmendur operon një sistem të cilësisë në përputhje me Direktivën Europiane 2014/68/BE. Prodhuesi ka lejen të vendosë shenjën e mëposhtëne CE në pajisjet e presionit të përshkruara dhe prodhuara në përputhje me fushën e mbuluar nga ky Sistem i Sigurimit të Cilësisë: CE 0035”, testuar sipas: “Direktivës 2014/68/EU: QA-System (Module H1)” referuar raportit të auditimit me numër no: 01 202 F/Q-05 20176, ku fusha e vlefshmërisë është: “Makineri sterilizimi për mbetje infektive të tipit ECODAS T100-T150-T300-T700-T1000-T2000 Kaldaja VE40k€-VE80k€, shih shtojcën e certifikatës: 01 202 F/Q-05 20176, rishikimi 4 nga 12/04/2023”, e vlefshme deri në datë 31.05.2026. (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 090300-134, viti prodhimit 2009, lloji Makineri për grirje/bluarje dhe sterilizim të mbetjeve nga veprimtari shëndetësore Ecodas. Modeli Ecodas T300. Lëshuar nga prodhuesi Ecodas. Në gjuhën Angleze (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 090300-134, viti prodhimit 2009, lloji Makineri për grirje/bluarje dhe sterilizim të mbetjeve nga veprimtari shëndetësore Ecodas. Modeli Ecodas T300. Lëshuar nga prodhuesi Ecodas. Në gjuhën Shqipe (1 faqe).
- Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-7608) me Titull Instalimi: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillim (5.2a)”, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillimit (5.2a). Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq. Sipërfaqe ndërtesë 262 m².”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”. (36 faqe).

Dokumentin e emërtuar “Inceneratori_(Pronesia-Karte_Teknologjike-CE)”, ku gjenden dokumentat e mëposhtëme:

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 44827, datë 27.06.2020, me eksportues shoqërinë kineze “ALBAN GROUP LIMITED” dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL” SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Incerator tip ËFS-150”. (1 faqe), shoqëruar me faturë eksporti me numër no; ALB20200422A, datë 22.04.2020, lëshuar nga shoqëria eksportuese “ALBAN GROUP LIMITED” për shoqërinë importuese “MEDI-TEL” SHPK, me objekt: “1 set Ëaste Incinerator ËFS-15, 5 suits Smoked Filter, 2 set Gas burner”.
- Dokumenti i emërtuar “ENCLOSER ËASTE INCINERATOR – Installation Instructions” i botuar nën autoritetin e kompanisë “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, në gjuhën angleze, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjeve të serisë “ËFS” (17 faqe).
- Dokumenti i emërtuar “ENCLOSER ËASTE INCINERATOR – Installation Instructions” i botuar nën autoritetin e kompanisë “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjeve të serisë “ËFS”. (16 faqe).
- Dokumenti “MACHINERY DIRECTIVE ATTESTATION OF CONFORMITY” me numër no: M.2025.206.C114726, datë 03.03.2025, në gjuhën angleze, e lëshuar nga kompania turke “UEM International Certification Auditing Training Centre Idustry and Trade Inc. Co”, e cila vërteton se: *“Technical file of the company mentioned beloë has been inspected and audit has been completed successfully 2006/42/EC Machibery Directive Annex VII has been taken as references for these processes”*, për prodhuesin “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, për produktin: Incinerator, sipas raportit të auditit me numër: ITCF0227-MD, për produktet e markës dhe modelit: “ËFS/LËFS/ËFS-20/ËFS-30/ËFS-50/ËFS-100/ËFS-150/ËFS-200/ËFS-300/ËFS-400/ËFS-500/LËFS—20/LËFS-50/LËFS-100/LËFS-150/LËFS-200/LËFS-300/LËFS-400/LËFS-500DËH-300”, e vlefshme deri në datë 03.03.2030. (1 faqe)
- Dokumenti “VËRTETIM KONFORMITETI I DIREKTIVAVE E MAKINËRISË” me numër no: M.2025.206.C114726, datë 03.03.2025, i përkthyer nga gjuha angleze dhe i noterizuar, e lëshuar nga kompania turke “UEM International Certification Auditing Training Centre Idustry and Trade Inc. Co”, e cila vërteton se: “Dosja teknike e kompanisë së përmendur më poshtë është inspektuar dhe auditimi ka përfunduar me sukses. Direktiva e Makinerisë 2006/42/EC Aneksi VII është marrë si referencë për këto procese”, për prodhuesin “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, për produktin: Incinerator, sipas raportit të auditit me numër: ITCF0227-MD, për produktet e markës dhe modelit: “ËFS/LËFS/ËFS-20/ËFS-30/ËFS-50/ËFS-100/ËFS-150/ËFS-200/ËFS-300/ËFS-

400/ËFS-500/LËFS—20/LËFS-50/LËFS-100/LËFS-150/LËFS-200/LËFS-300/LËFS-400/LËFS-500DËH-300”, e vlefshme deri në datë 03.03.2030. (1 faqe).

- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 200050420, Produkti Incenerator i Mbetjeve Mjeksove Kinë. Modeli ËFS-150. Lëshuar nga prodhuesi SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD. Në gjuhën Angleze (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 200050420, Produkti Incenerator i Mbetjeve Mjeksove Kinë. Modeli ËFS-150. Lëshuar nga prodhuesi SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD. Në gjuhën Shqipe (2 faqe).

Dokumentin e emërtuar “Pajisja_Larese_(Pronesi-Karte_Teknologjike-_CE)”, ku gjenden dokumentat e mëposhtëme:

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 70155, datë 14.09.2020, me eksportues shoqërinë italiane “PRC IMPIANTI” S.r.l dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL” SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Pajisje për larjen e kontenierëve”. (1 faqe), shoqëruar me faturë eksporti me numër no; 000178/2020, datë 09.09.2020, lëshuar nga shoqëria eksportuese “PRC IMPIANTI” S.r.l për shoqërinë importuese “MEDI-TEL” SHPK, me objekt: “Macchina a cabina mod. PI LVG 15 e lava contenitori rifiuti”.
- Dokumenti i emërtuar “MACCHINA LAVACONTENITORI RIFIUTI OSPEDALIERI – PI LVG 15E” i botuar nën autoritetin e kompanisë “PRC IMPIANTI” S.r.l, në gjuhën italiane, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjes të modelit “PI PLV 15E”. (23 faqe)
- Dokumenti i emërtuar “MAKINË KONTENIER LARËSE E MBETJEVE SPITALORE – PI LVG 15E” i botuar nën autoritetin e kompanisë “PRC IMPIANTI” S.r.l, i përkthyer nga gjuha italiane dhe i noterizuar, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjes të modelit “PI PLV 15E”. (22 faqe)
- Dokumenti “DICHIARAZIONE DI CONFORMITA” datë 13 korrik 2018, në gjuhën italiane, e lëshuar nga kompania prodhuese “PRC IMPIANTI” S.r.l, e cila deklaron se: “Macchina lavacontenitori rifiuti ospedalieri – PI LVG 15 E, e conforme alle seguenti norme: EN 60335-1, EN 60335-2-58, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3, EN 55014-1, EN 50366-2023, in base a quanto previsto dalle Direttive CEE: 2006//42/CE, 2006/95/CE(LVD) e 2006/108/CE(EMC)”, (1 faqe)
- Dokumenti “DEKLARATË KONFORMITETI” datë 13 korrik 2018, i përkthyer nga gjuha italiane dhe i noterizuar, e lëshuar nga kompania prodhuese “PRC IMPIANTI” S.r.l, e cila vërteton se: “Nakinë kontejnerlarëse e mbetjeve spitalore – model: PI LVG

15E, përputhet me standartet e mëposhtëme: EN 60335-1, EN 60335-2-58, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3, EN 55014-1, EN 50366-2023, sipas dispozitave të udhëzimeve të KEE-së: CEE: 2006/42/CE, 2006/95/CE(LVD) e 2006/108/CE(EMC)”. (1 faqe).

Për pikën 2.1.1 dhe pikën 2.1.2 “Kapaciteti profesional” të shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit

- Akt Miratimi “Leje Mjedisi **Tipi B**” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-7608) me **Titull Instalimi: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillim (5.2a)”**, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillimit (5.2a). Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq. Sipërfaqe ndërtesë 262 m².”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”. (36 faqe).
- Akt Miratimi “Leje Mjedisi **Tipi A**” nr. 3133/1, datë 28.04.2023, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4473) me **Titull Instalimi: “Menaxhim i mbetjeve”**, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “I.D 5.1/a Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. I.D 5.1/c Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1/a. ID 5.6/a Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren. ID 5.10/a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart. ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart, Siperfaqja e ndërtesës ku zhvillohet aktiviteti është 262 m². Kapaciteti i projektuar për incinerim është 1 ton/orë.”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”, ku në tabëlën 1.1.2 – Lista e veprimtarive të lidhura me to është përcaktuar si në vijim: “Incineratori që do të instalohet është “Mediburn 30” prodhuar nga Elastec në strukturë të certifikuar ISO 9001:2008”. (54 faqe)
- Akt Miratimi “**Licensë e kategorisë III.2.B**” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4073), me aktivitet të licensuar: “**Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjесim i mbetjeve të rrezikshme spitalore**”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë”. (3 faqe).
- Akt Miratimi “**Licensë e kategorisë III.2.B**” nr. 384/3, datë 03.07.2023, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-2619) me aktivitet të licensuar: “**Grumbullimi, depozitim, transportim, trajtim dhe asgjесim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me metodën e ininerimit**”, me

vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë”. (3 faqe).

- Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: **PN-4737-03-2017**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Leje mjedisi e tipi B për Asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1a) ose lëndfillimit (5.2a)”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).
- Leje mjedisi e tipit A, me kodin: III.1.C, me numër: PN-9903-03-2020, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Leje mjedisi e tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).
- Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).
- Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-0357-03-2020, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, depozitim, transportim, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me metodën incinerimit.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).
- Vërtetim datë 22.12.2025, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial nga ku thuhet se: “Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. gjurmimi MIE-2025-5080650-JL, vërtetojmë se shoqëria Medi Tel SHPK me nipt J71519004Ë dhe adresë Mëzez, Kashar, Tiranë, ju bëjmë me dije se ka të regjistruar në ISHTI këto pajisje nën presion:

- 1- Autoklave tipi Ecodas T-300 me nr. regjistri 334 dhe nr. fabrikimi 090300-134, volume 1111 litra dhe viti i prodhimit 2009.
- 2- Rezervuar ajri me nr. regjistri 335 dhe nr. fabrikimi 7090, volume 270 litra dhe viti i prodhimit 2008.
- 3- Kaldajë me nr. regjistri 185, nr. fabrikimi 4369, volume 463 lira dhe viti i prodhimit 2009.

III.1.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.8. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.9. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.
- Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.11. Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. 6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriteret e veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

III.1.12. Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfutues në regjistrin e pronarëve përfutues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.13. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;*
- d) *Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.1.14. Në nenin 11 “Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipave A dhe B” të Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kërkesat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në këtë ligj, deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja.”.

III.1.15. Ndërsa në Shtojcën 1 të Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë vijon:

Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. N.q.s. nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.	Të gjitha instalimet.	
		b. Incinerimi i mbetjeve urbane jo të rrezikshme.	Të gjitha instalimet.	

		c. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë.	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq.
	5.2	a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10 ton/ditë ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është më i madh se 25000 tonë.	Kapaciteti i depozitues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është 25000 tonë ose më pak se kaq.
		b. Lendfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet.
	5.3	a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		d. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.

		e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet.
	5.4	a. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9.	Të gjitha instalimet.	
		b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet.
		c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme		Të gjitha instalimet.
	5.5	Magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.6	a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		b. Magazinin i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/dite ose më i madh se kaq.
	5.7	Magazinin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (EEEE).		Të gjitha instalimet.

	5.8	Magazininim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.		Të gjitha instalimet.
	5.9	Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.		Të gjitha instalimet.
	5.1	a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet.
		b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.11	Kompostim i mbetjeve bio.		Kapaciteti i kompostimit më i madh se 50 ton/ditë.

III.1.16. Në VKM Nr. 419 datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedis të Tipave A dhe B, Për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt te Tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit, si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e këtyre Lejeve nga QKB-ja”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

KREU II

Procedurat për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Përcaktimi i Kushteve Për Leje Mjedis të Tipit A

1. Kërkuesi që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “e-Albania”, për pajisjen me leje mjedis të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7. 2011, “Për lejet e mjedisit”;

c) çdo dokument tjetër i nevojshëm që vërteton deklaratimet në formularin informues, që kërkuuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

ç) Shfuqizuar;

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga

aksidentet madhore, kur kërkohet;

dh) Relacion rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

...

7. Formati standard i aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit, për lejet e mjedisit të tipit A, është sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

KREU III

Procedurat për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Përcaktimi i Kushteve Për Leje Mjedisit Të Tipit B

1. Kërkuuesi, që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “e-Albania” për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;

c) çdo dokument tjetër i nevojshëm, që vërteton deklaratimet në formularin informues që kërkuuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

ç) Shfuqizuar.

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.

dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

...

7. Formati standard i aktit të miratimit dhe i aktit të refuzimit për lejet e mjedisit të tipit B është sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. ____ Prot.

Datë _____

KËRKESË PËR LEJE MJEDISI Tipi A

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Numri i Identifikimit të Kërkesës

Emri i Kërkuesit:

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTi, adresa,)

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....)

Për implantin/installimin:

1. Titulli i instalimit (përkruaj sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar).....
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përkruaj sipas kolumnës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar).....
3. Vendndodhja.....

(Qark)

(Bashki)

(Komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar

(Firma, Vula)

Data.....

Tarifa e paguar në datë

☐ për kërkesë për leje mjedisi

☐ ndryshim të kushteve të lejes

SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. ___ Prot.

Data _____

KËRKESË PËR LEJE MJEDISI

Tipi B

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Numri i identifikimit të Kërkesës

Emri i Kërkuesit:

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....)

Për implantin/installimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar) _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolumnës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar) _____
3. Vendndodhja _____

(Qark)

(Bashki)

(komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar

(Firma, Vula)

Data.....

Tarifa e paguar në datë

- ☐ për kërkesë për leje mjedisi
☐ ndryshim të kushteve të lejes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI
LEFTER KOKA

Nr. ____Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrat të AKM)

(firma, vula)

Datë _____

AKT MIRATIMI Leje Mjedisi Tipi A

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për implantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit") _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kullonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit") _____
3. Vendndodhja _____

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë _____

Tarifa e paguar në datë _____

☐ për kërkesë për leje mjedisi

☐ ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

(emri, mbiemri, firma, vula)


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI
LEFTER KOKA

(firma, vula)

Nr. ____ Prot.
Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM) _____ Datë _____

AKT MIRATIMI
Leje Mjedisore Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisore, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,) _____

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT.....) _____

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kullonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
3. Vendndodhja _____

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë _____

Tarifa e paguar në datë _____

☐ për kërkesë për leje mjedisore

☐ ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM
(emri, mbiemri, firma, vula)

III.1.17. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.18. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi dhe konkretisht të pajisjeve si në vijim: “1. *Implant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - copë 1*; 2. *Implant për asgjësimin me incenerim - copë 1 dhe 3. Makineri për larjen e kontenierëve- copë 1*”, ku disponimin e këtyre pajisjeve do ta vërtetojnë duke paraqitur **a.** dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi); **b.** të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër; **c.** katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit implant dhe makinerisë; **d.** deklaratë konformiteti CE i secilit implant dhe makinerisë, si dhe për të siguruar autoritetin kontraktor se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent (referuar procesverbalit të datës 24.03.2026 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor)

ka përcaktuar se këto pajisje duhet të jenë të pasqyruara në Akt Miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 të përcaktuara në shtojcën 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar se në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë ofertues do ta vërtetojnë disponimin e këtyre makinerive nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 10 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” (pjesë e dokumentave të tenderit), duke përfshirë të dhënat si vijon: “*emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër)*”, ndërsa në rastin kur operatori ekonomik ofertues kualifikohet i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet që të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të vërtetuar deklaratimet e bëra në Shtojcën 10 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës.

Ndërkohë nga shqyrtimi i kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 “*Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë*” të shtojcës 9/2 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për metodat apo teknologjitë e trajtimit të mbetjeve spitalore të ndryshme nga metoda e “*Incelerimit*” duhet që të paraqesin Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës dhe Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si në vijim: “18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet dhe 18 01 04 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (psh, veshje, hedhurinat e leokoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj)”, ndërkohë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për metodën apo teknologjinë e trajtimit të mbetjeve spitalore me “*Incelerim*” duhet që të paraqesin Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës dhe Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijë kodin e mbetjeve të rrezikshme si në vijim: “18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”.

Në përfundim të analizës së këtyre kriterëve kualifikuesë, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të shtojcës 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor e konsideron të përmbushur këtë kriter kualifikues nga ana e operatorit ekonomik ofertues të kualifikuar i pari vetëm në rastin se nga ana e këtij të fundit plotësohen 4 (katër) kushte, të cilat janë kumulative dhe konkretisht ky kriter konsiderohet i plotësuar në rastin kur operatori ekonomik ofertues i kualifikuar i para paraqet dokumentacionin si në vijim: “Dokumentacioni që vërteton disponimin e 1 (një) Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të 1 (një) Impiant për asgjësimin me incenerim dhe të 1 (një) Makineri për larjen e kontenierëve (Kushti i parë); Katalogun apo skedën teknike të Impiantit për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente),

të Implantit për asgjësimin me incenerim dhe të Makinerisë për larjen e kontenierëve (Kushti i dytë); Deklaratën e konformitetit të Implantit për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të Implantit për asgjësimin me incenerim dhe të Makinerisë për larjen e kontenierëve (Kushti i tretë), si dhe Akt Miratimin e Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B), Akt Miratimin e Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore), Akt Miratimin e Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) e Akt Miratimin e Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore), ku në këto Akte Miratimi të jetë pasqyruar Impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të Impianti për asgjësimin me incenerim dhe Makinaria për larjen e kontenierëve (Kushti i katërt).”.

III.1.19. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E RECYCLING” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Medi - Tel” SHPK, të parashtruar në pikën III.1 të këtij vendimi, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK për metodën dhe teknologjinë e trajtimit të mbetjeve spitalore të ndryshme nga metoda e “Incenerimit” dhe konkretisht për metodën me “Sterilizim (autoklavë)” ka paraqitur në dokumentacionin e ofertës dokumentat si në vijim: “Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “Medi Tel” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.” shoqëruar me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “Medi-Tel” SHPK (LC-4073) me aktivitet të licensuar: “Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”.

Përsa i përket kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “Medi-Tel” SHPK ka dorëzuar Shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku në Seksionin B “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka deklaruar si vijon: “XXX - Primar - Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B)- Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim)- 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03): 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave kerkon traitim te veçante per te parandaluar infeksionet;”, ku për metodën e trajtimit të mbetjeve spitalore me “Autoklavim” disponon pajisjen e autoklavimit model “XXX” (pajisje e cila është primare) dhe se për këtë metodë është i pajisur me Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) dhe Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) që përfshin kodet si në vijim: “18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi

dhe asgjesimi i te cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;”, si dhe licencat dhe aktet e miratimit të cituara në pikën III.1.6 të vendimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionin të dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik ofertues “Medi-Tel” dhe të cituar në pikën III.1.6 si më sipër, Komisioni konstaton se për përmbushje të deklarimeve të bëra më sipër, ky operator ekonomik ofertues ka paraqitur Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.” shoqëruar me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4073) me aktivitet të licensuar: ‘Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme spitalore’, ku nga shqyrtimi i Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit dhe Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “Medi-Tel” SHPK konstatohet se në asnjë rubrikë të këtyre akteve të miratimit nuk është pasqyruar që për metodën e trajtimit të mbetjeve spitalore me “Autoklavim” të jetë e instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “Ecodas T300”, sikurse ka deklaruar ky operator ekonomik ofertues në Shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”.

Për më tepër, referuar korespondencës së Komisionit Prokurimit Publik me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në një rast të ngjashëm me të njëjtat subjekte rezulton se me shkresës nr. 8804/1 prot, datë 20.08.2025, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1944/12 prot, datë 22.08.2025, Komisioni konstaton *aktet e miratimit janë sipas formatit të miratuar me VKM-në Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", e ndryshuar dhe VKM-së Nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashketa", e ndryshuar, dhe se këto akte përmbajnë përshkrimin e veprimtarisë sipas vetëdeklarimeve të subjekteve, ku në rastin konkret subjekti për të cilin janë miratuar këto akte nuk ka deklaruar llojin, modelin dhe kapacitetin e impiantit për traktimin e metjeve spitalore me metodën “Autoklavim”.* Gjithashtu referuar dhe korespondencës së Komisionit Prokurimit Publik me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për ankesën objekt shqyrtimi rezulton se me shkresës nr. 8925/1 prot, datë 12.06.2026, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1459/4 prot, datë 12.06.2026, rezulton se “Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 1459/3 prot, datë 05.06.2026, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Nr. 8925 prot, datë 08.06.2026, me lëndë “Kërkesë për informacion për subjektin Medi Tel”, ju bëjmë me dije se: Nga verifikimet për subjektin “Medi Tel” me NUIS J71519004Ë, rezultojnë të publikuara në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave pranë QKB-së: - Leje e mjedisit e tipit B, me PN-4737-03-2017, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Asgjësimi I mbetjeve të

rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2 a), vendi i kryerjes së veprimtarisë; Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. Pronësie 41/1/16/2 me Akt Miratimi Nr. 2959 Prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11, ku janë të pasqyruara të gjitha të dhënat e instalimit, për veprimtrainë, proceset, metodat dhe kapacitetin. - Licencë e nënkategorisë me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, vendi i kryerjes së veprimtarisë: Tiranë, Autostrada Tiranë Durrës, Km.1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zonë Kadastrale Nr. 2679, Nr. pronësisë 41/1/16/2, me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45, ku janë të pasqyruara lloji i mbetjeve për grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim deri në asgjësim. Bashkëlidhur shkresës gjeni kopje të lejes së mjedisit me PN-4737-03-2017, Akt Miratimi Nr. 2959 prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11 dhe Licencës me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019 me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45.

Përsa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, argumentimit të kriterit kualifikues dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “Medi Tel” SHPK, për vërtetimin e kriterit kualifikues, Komisioni gjykon se ky i fundit nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në Akt Miratimin “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit dhe në Akt Miratimi “Licencë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “Medi Tel” SHPK nuk evidentohet se për metodën e trajtimit të metjeve spitalore me “Autoklavim” në këto akte të jetë e pasqyruar që ky subjekt ka të instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “ECODAS T300”, duke mos plotësuar kushtin e katër kumulativ të përmendur në pikën III.2.15 të këtij vendimi dhe për më tepër në përgjigjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A referuar shkresës nr. 1431/8 prot., datë 05.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1275/3 prot., datë 07.05.2026 ku evidenton si në vijim: “Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, “Medi-Tel” shpk konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur dokumentacionin që zotëron mjetet e kërkuara, të dhënat teknike si dhe pasqyrimin e tyre në aktet e miratimeve të lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për lejet dhe licensat”, nuk evedentohet se në cilën rubrikë të akt miratimeve të sipërpërmendura është pasqyruar instalimi i impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “Ecodas T300”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E RECYCLING” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Medi Tel” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit nr. 69 prot, datë 05.05.2026, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt – shqyrtimi, si rrjedhojë e pranimit të ankesës nr. 1275 prot, datë 27.04.2026, me argumentin se operatori ekonomik

“Medi Tel” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3.4 të dokumnetave të tenderit pasi në dokumentacionin e paraqitur për vërtetimin e këtij kriteri nuk evedentohet se në cilën rubrikë të akt miratimeve është pasqyruar instalimi i impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “Ecodas T300”, gjithashtu referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Medi Tel” SHPK ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe ankesën pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Komisioni ndodhur para këtij fakti, bazuar në nenin 115 pika 1 gërma b të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, do të vijojë me shqyrtimin e çështjes në themel për ankesën e operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK mbi kundërshtimin e Vendimit nr. 69/2026 prot, datë 05.05.2026, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.3.4. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr.10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.3. Në procesverbalin e datës 24.03.2026 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A ka argumentuar vendosjen e kriterëve kualifikues të përcaktuara në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, impiantet për realizimin e trajtimit të kategorive të caktuara të mbetjeve spitalore, janë pajisjet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

Pasqyrimi në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 vërtetojnë se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e trete, ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e trete të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë, si dhe Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë provon përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

III.2.4. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.1.1 dhe 2.1.2 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.1.1 Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, në VKM nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe në Termat e Referencës së DST (përveç incenerimit), ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,

si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshte:

- **18 01 01** - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- **18 01 03** - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;
- **18 01 04** - Mbetjet e buta (grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për parandalimin e infeksioneve).

2.1.2 Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit me Incenerim, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 02** - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

III.2.5. Në procesverbalin e datës 24.03.2026 “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A ka argumentuar vendosjen e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 798, date 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesi Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 “Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

III.2.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK në fazën e ofertimit për plotësimin e kritereve kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.1.1, 2.1.2 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë

vijon, dokumentacion të cilin referuar kthim përgjigjes së AK dhe rubrikës kërkesa në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton ta ketë dorëzuar edhe pranë pranë autoritetit kontraktor:

Për pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

- Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë “MEDI-TEL” SHPK, ku në Seksionin B “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka deklaruar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <u>Profili i punonjësve</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: ECODAS T300-Primar - Leje Mjedisore I 1 B (Tipi B)-Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim)- 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (perveç 18 01 03): 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon traitim te veçante per te parandaluar infeksionet; WFS-150 –Primar - Leje Mjedisore III 1C (Tipi A) - Licence III 2 B (Per trajtim dhe asgjesim i mbetjeve te rrezikshme me metoden incenerimit.) (Incenerim)- 18 01 02 - Pjese te trupit dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (perve 18 01 03);

	18 01 08 – Medikamente citostatike dhe citotoksike, 18 01 09 – Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08. PI LVG 15 E -Primar -Leje Miedisore III 1C (Tipi A) Paisja larese per kontenitoret shumepdorimesh. AA511VC etj...
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

**Dokumentin e emërtuar “Autoklva_ECODAS (Pronesia_Leje-Karte_Teknologjike-CE)”,
ku gjenden dokumentat e mëposhtme:**

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 11705, datë 19.03.2009, me eksportues shoqërinë franceze “ESODAS” SAS dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL” SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Autoklav për trajtimin e mbetjeve”. (1 faqe)
- Deklaratë e lëshuar nga presidenti i kompanisë franceze “ECODAS” e datës 13 shkurt 2009, në gjuhën angleze, i cili deklaron si më poshtë vijon (1 faqe):

“
TO WHOM IT MAY CONCERN
We, ECODAS located 28 rue Sébastopol 59100 - ROUBAIX - FRANCE hereby certifies that:
MEDITEL
LocatedrR Qemal Stafa Nr 51 - TIRANA - ALBANIA
Is authorized to treat medical waste in our machine ECODAS T300
Made in Roubaix - FRANCE, on February 13 2009.”.

- Deklaratë e lëshuar nga presidenti i kompanisë franceze “ECODAS” e datës 13 shkurt 2009, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar, i cili deklaron si më poshtë vijon (1 faqe):

“**ATIJ QË MUND T’I INTERËSOJË**
Ne, ECODAS E NDODHUR NË 28 ME Sebastopol 59100 – ROUBAIX – FRANCE vërteton
se;
MEDITEL
E ndodhur në R Qemal Stafa Nrr 51 – Tiranë – Shqipëri është e autorizuar për të trajtuar
mbetjet mjekësore në makinerinë tonë ECODAS T300 bërë në Roubaix – Francë, më 13 shkurt
2009

Firma, vula”.

- Dokumenti i emërtuar “ENGINEERED SOLUTIONS FOR HEALTH & THE ENVIRONMENT” i prodhuar nën autoritetin e shoqërisë “ECODAS”, në gjuhën angleze, ku jepen parametrat teknike, certifikimet dhe procesi teknologjik i pajisjeve “ECODAS T150”, “ECODAS T300”, “ECODAS T1000” dhe “ECODAS T2000”. (10 faqe)
- Dokumenti i emërtuar “ENGINEERED SOLUTIONS FOR HEALTH & THE ENVIRONMENT” i prodhuar nën autoritetin e shoqërisë “ECODAS”, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar ku jepen parametrat teknike, certifikimet dhe procesi teknologjik i pajisjeve “ECODAS T150”, “ECODAS T300”, “ECODAS T1000” dhe “ECODAS T2000”. (6 faqe)
- Certifikatë “QUALITY ASSURANCE SYSTEM acc. to Directive 2014/68/EU” me numër no: 01 202 F/Q-05 20176.00, datë 11.07.2023, në gjuhën angleze, e lëshuar nga trupa e njoftuar “TUV Rheinland Industrie Service” GmbH, për prodhuesin “ECODAS”, e cila vërteton se: “Hereëith ëe certify that the above-mentioned manufacturer operates a quality system according to the European Directive 2014/68/EU. The manufacturer has the permission to affix the folloëing CE marking to pressure equipment described and manufactured in accordance to the scope covered by Quality-Assurance System: C€ 0035”, sipas testimit bazik: “Directive 2014/68/EU: QA-System (Module H1)” referuar raportit të auditit me numër no: 01 202 F/Q-05 20176, ku qëllimi është: “Sterilization machines for infectious ëaste of type ECODAS T100-T150-T300-T700-T1000-T2000 Boilers VE40kË-VE80kË, see annex to certificate: 01 202 F/Q-05 20176, revision 4 from 12/04/2023”, e vlefshme deri në datë 31.05.2026. (1 faqe)
- Certifikatë “Sistemi i Sigurimit të Cilësisë sipas Direktivës 2014/68/EU” me numër no: 01 202 F/Q-05 20176.00, datë 11.07.2023, e përkthyer dhe e noterizuar nga dokumenti origjinal në gjuhën angleze, e lëshuar nga trupa e njoftuar “TUV Rheinland Industrie Service” GmbH, për prodhuesin “ECODAS”, e cila vërteton se: “Me këtë, ne vërtetojme se prodhuesi i lartëpërmendur operon një sistem të cilësisë në përputhje me Direktivën Europiane 2014/68/BE. Prodhuesi ka lejen të vendosë shenjën e mëposhtëne CE në pajisjet e presionit të përshkruara dhe prodhuara në përputhje me fushën e mbuluar nga ky Sistem i Sigurimit të Cilësisë: CE 0035”, testuar sipas: “Direktivës 2014/68/EU: QA-System (Module H1)” referuar raportit të auditimit me numër no: 01 202 F/Q-05 20176, ku fusha e vlefshmërisë është: “Makineri sterilizimi për mbetje infektive të tipit ECODAS T100-T150-T300-T700-T1000-T2000 Kaldaja VE40kË-VE80kË, shih shtojcën e certifikatës: 01 202 F/Q-05 20176, rishikimi 4 nga 12/04/2023”, e vlefshme deri në datë 31.05.2026. (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 090300-134, viti prodhimit 2009, lloji Makineri për grirje/bluarje dhe sterilizim të mbetjeve nga veprimtari shëndetësore

Ecodas. Modeli Ecodas T300. Lëshuar nga prodhuesi Ecodas. Në gjuhën Angleze (1 faqe).

- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 090300-134, viti prodhimit 2009, lloji Makineri për grirje/bluarje dhe sterilizim të mbetjeve nga veprimtari shëndetësore Ecodas. Modeli Ecodas T300. Lëshuar nga prodhuesi Ecodas. Në gjuhën Shqipe (1 faqe).
- Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-7608) me Titull Instalimi: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lëndfillim (5.2a)”, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lëndfillimit (5.2a). Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq. Sipërfaqe ndërtesë 262 m².”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”. (36 faqe).

Dokumentin e emërtuar “*Inceneratori_(Pronesia-Karte_Teknologjike-CE)*”, ku gjenden dokumentat e mëposhtëme:

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 44827, datë 27.06.2020, me eksportues shoqërinë kineze “ALBAN GROUP LIMITED” dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL” SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Incerator tip ĖFS-150”. (1 faqe), shoqëruar me faturë eksporti me numër no; ALB20200422A, datë 22.04.2020, lëshuar nga shoqëria eksportuese “ALBAN GROUP LIMITED” për shoqërinë importuese “MEDI-TEL” SHPK, me objekt: “1 set Ėaste Incinerator ĖFS-15, 5 suits Smoked Filter, 2 set Gas burner”.
- Dokumenti i emërtuar “ENCLOSER ĖASTE INCINERATOR – Installation Instructions” i botuar nën autoritetin e kompanisë “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, në gjuhën angleze, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjeve të serisë “ĖFS” (17 faqe).
- Dokumenti i emërtuar “ENCLOSER ĖASTE INCINERATOR – Installation Instructions” i botuar nën autoritetin e kompanisë “SHANDONG BETTER ENVIROMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, në gjuhën angleze, i përkthyer dhe i noterizuar, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjeve të serisë “ĖFS”. (16 faqe).
- Dokumenti “MACHINERY DIRECTIVE ATTESTATION OF CONFORMITY” me numër no: M.2025.206.C114726, datë 03.03.2025, në gjuhën angleze, e lëshuar nga kompania turke “UEM International Certification Auditing Training Centre Idustry and Trade Inc. Co”, e cila vërteton se: “*Technical file of the company mentioned beloë has*

been inspected and audit has been completed successfully 2006/42/EC Machinery Directive Annex VII has been taken as references for these processes”, për prodhuesin “SHANDONG BETTER ENVIRONMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, për produktin: Incinerator, sipas raportit të auditit me numër: ITCF0227-MD, për produktet e markës dhe modelit: “WFS/LWFS/WFS-20/WFS-30/WFS-50/WFS-100/WFS-150/WFS-200/WFS-300/WFS-400/WFS-500/LWFS—20/LWFS-50/LWFS-100/LWFS-150/LWFS-200/LWFS-300/LWFS-400/LWFS-500DWH-300”, e vlefshme deri në datë 03.03.2030. (1 faqe)

- Dokumenti “VËRTETIM KONFORMITETI I DIREKTIVAVE E MAKINËRISË” me numër no: M.2025.206.C114726, datë 03.03.2025, i përkthyer nga gjuha angleze dhe i noterizuar, e lëshuar nga kompania turke “UEM International Certification Auditing Training Centre Industry and Trade Inc. Co”, e cila vërteton se: “Dosja teknike e kompanisë së përmendur më poshtë është inspektuar dhe auditimi ka përfunduar me sukses. Direktiva e Makinerisë 2006/42/EC Aneksi VII është marrë si referencë për këto procese”, për prodhuesin “SHANDONG BETTER ENVIRONMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD, për produktin: Incinerator, sipas raportit të auditit me numër: ITCF0227-MD, për produktet e markës dhe modelit: “WFS/LWFS/WFS-20/WFS-30/WFS-50/WFS-100/WFS-150/WFS-200/WFS-300/WFS-400/WFS-500/LWFS—20/LWFS-50/LWFS-100/LWFS-150/LWFS-200/LWFS-300/LWFS-400/LWFS-500DWH-300”, e vlefshme deri në datë 03.03.2030. (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 200050420, Produkti Incenerator i Mbetjeve Mjeksores Kinë. Modeli WFS-150. Lëshuar nga prodhuesi SHANDONG BETTER ENVIRONMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD. Në gjuhën Angleze (1 faqe).
- Deklarate Konformiteti CE me Nr. Serie 200050420, Produkti Incenerator i Mbetjeve Mjeksores Kinë. Modeli WFS-150. Lëshuar nga prodhuesi SHANDONG BETTER ENVIRONMENTAL PROTECTION TECHNOLOGY CO” LTD. Në gjuhën Shqipe (2 faqe).

Dokumentin e emërtuar “Pajisja_Larese_(Pronesi-Karte_Teknologjike-_CE)”, ku gjenden dokumentat e mëposhtëme:

- Deklarate doganore IM4, me numër nr; R 70155, datë 14.09.2020, me eksportues shoqërinë italiane “PRC IMPIANTI” S.r.l dhe importues shoqërinë shqiptare “MEDI-TEL” SHPK, ku vërtetohet importimi i mallit me përshkrimin si në vijim: “Pajisje për larjen e kontenierëve”. (1 faqe), shoqëruar me faturë eksporti me numër no; 000178/2020, datë 09.09.2020, lëshuar nga shoqëria eksportuese “PRC IMPIANTI” S.r.l për shoqërinë importuese “MEDI-TEL” SHPK, me objekt: “Macchina a cabina mod. PI LVG 15 e lava contenitori rifiuti”.

- Dokumenti i emërtuar “MACCHINA LAVACONTENITORI RIFIUTI OSPEDALIERI – PI LVG 15E” i botuar nën autoritetin e kompanisë “PRC IMPIANTI” S.r.l, në gjuhën italiane, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjes të modelit “PI PLV 15E”. (23 faqe)
- Dokumenti i emërtuar “MAKINË KONTENIER LARËSE E MBETJEVE SPITALORE – PI LVG 15E” i botuar nën autoritetin e kompanisë “PRC IMPIANTI” S.r.l, i përkthyer nga gjuha italiane dhe i noterizuar, ku jepen parametrat teknike, dhe procesi teknologjik i pajisjes të modelit “PI PLV 15E”. (22 faqe)
- Dokumenti “DICHIARAZIONE DI CONFORMITA” datë 13 korrik 2018, në gjuhën italiane, e lëshuar nga kompania prodhuese “PRC IMPIANTI” S.r.l, e cila deklaron se: “Macchina lavacontenitori rifiuti ospedalieri – PI LVG 15 E, e conforme alle seguenti norme: EN 60335-1, EN 60335-2-58, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3, EN 55014-1, EN 50366-2023, in base a quanto previsto dalle Direttive CEE: 2006//42/CE, 2006/95/CE(LVD) e 2006/108/CE(EMC)”, (1 faqe)
- Dokumenti “DEKLARATË KONFORMITETI” datë 13 korrik 2018, i përkthyer nga gjuha italiane dhe i noterizuar, e lëshuar nga kompania prodhuese “PRC IMPIANTI” S.r.l, e cila vërteton se: “Nakinë kontejnerlarëse e mbetjeve spitalore – model: PI LVG 15E, përputhet me standartet e mëposhtëme: EN 60335-1, EN 60335-2-58, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3, EN 55014-1, EN 50366-2023, sipas dispozitave të udhëzimeve të KEE-së: CEE: 2006//42/CE, 2006/95/CE(LVD) e 2006/108/CE(EMC)”. (1 faqe).

Për pikën 2.1.1 dhe pikën 2.1.2 “Kapaciteti profesional” të shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit

- Akt Miratimi “Leje Mjedisi **Tipi B**” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-7608) me **Titull Instalimi: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillim (5.2a)”**, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1a), ose lenfillimit (5.2a). Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq. Sipërfaqe ndërtesë 262 m².”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”. (36 faqe).
- Akt Miratimi “Leje Mjedisi **Tipi A**” nr. 3133/1, datë 28.04.2023, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4473) me **Titull Instalimi: “Menaxhim i mbetjeve”**, me Përshkrim Veprimtarie dhe kapaciteti prodhues: “I.D 5.1/a Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. I.D 5.1/c Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1/a. ID 5.6/a Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren. ID

5.10/a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart. ID 5.10/b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart, Siperfaqja e ndërtesës ku zhvillohet aktiviteti është 262 m². Kapaciteti i projektuar për incinerim është 1 ton/orë.”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë.”, ku në tabëlën 1.1.2 – Lista e veprimtarive të lidhura me to është përcaktuar si në vijim: “Incineratori që do të instalohet është “Mediburn 30” prodhuar nga Elastec në strukturë të certifikuar ISO 9001:2008”. (54 faqe)

- Akt Miratimi “**Licensë e kategorisë III.2.B**” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4073), me aktivitet të licensuar: “**Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore**”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë”. (3 faqe).
- Akt Miratimi “**Licensë e kategorisë III.2.B**” nr. 384/3, datë 03.07.2023, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-2619) me aktivitet të licensuar: “**Grumbullimi, depozitim, transportim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me metodën e ininerimit**”, me vendndodhje: “Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2, Mëzez, Kashar, Tiranë”. (3 faqe).
- Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: **PN-4737-03-2017**, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Leje mjedisi e tipi B për Asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1a) ose lëndfillimit (5.2a)”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).
- Leje mjedisi e tipit A, me kodin: III.1.C, me numër: PN-9903-03-2020, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Leje mjedisi e tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.”. (1 faqe).

- Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: *Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.*”. (1 faqe).
- Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-0357-03-2020, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, depozitim, transportim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me metodën incenerimit.”, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është në adresën: “Qarku Tiranë Rrethi Tiranë, B/K: Kashar Q/F: Adresa: *Autosdrada TIRANË – Durrës, Km. 1, Rruga “Vidhegjatë”, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr Pronësie 41/1/16/2.*”. (1 faqe).
- Vërtetim datë 22.12.2025, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial nga ku thuhet se: “Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. gjurmimi MIE-2025-5080650-JL, vërtetojmë se shoqëria Medi Tel SHPK me nipt J71519004Ë dhe adresë Mëzez, Kashar, Tiranë, ju bëjmë me dije se ka të regjistruar në ISHTI këto pajisje nën presion:
 - 4- Autoklave tipi Ecodas T-300 me nr. regjistri 334 dhe nr. fabrikimi 090300-134, volume 1111 litra dhe viti i prodhimit 2009.
 - 5- Rezervuar ajri me nr. regjistri 335 dhe nr. fabrikimi 7090, volume 270 litra dhe viti i prodhimit 2008.
 - 6- Kaldajë me nr. regjistri 185, nr. fabrikimi 4369, volume 463 litra dhe viti i prodhimit 2009.

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.8. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.9. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.10. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.11. Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. 6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve.

Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriteret e veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

III.2.12. Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.2.13. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.2.14. Në nenin 11 “Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipave A dhe B” të Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kërkesat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në këtë ligj, deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja.”.

III.1.15. Ndërsa në Shtojcën 1 të Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë vijon:

Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. N.q.s. nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.	Të gjitha instalimet.	
		b. Incinerimi i mbetjeve urbane jo të rrezikshme.	Të gjitha instalimet.	
		c. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë.	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq.
	5.2	a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10 ton/ditë ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është më i madh se 25000 tonë.	Kapaciteti depozitues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është 25000 tonë ose më pak se kaq.
		b. Lendfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet.

	5.3	a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lëndfillimit (5.2 a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8).	Kapaciteti përpunimit është më i madh se 10ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		d. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet.
	5.4	a. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9.	Të gjitha instalimet.	
		b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet.
		c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme		Të gjitha instalimet.
	5.5	Magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.

	5.6	a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		b. Magazinin i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/dite ose më i madh se kaq.
	5.7	Magazinin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (EEEE).		Të gjitha instalimet.
	5.8	Magazinin, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.		Të gjitha instalimet.
	5.9	Magazinin i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.		Të gjitha instalimet.
	5.1	a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet.

		b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.11	Kompostim i mbetjeve bio.		Kapaciteti i kompostimit më i madh se 50 ton/ditë.

III.2.16. Në VKM Nr. 419 datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedis të Tipave A dhe B, Për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt të Tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit, si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e këtyre Lejeve nga QKB-ja”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

KREU II

Procedurat për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Përcaktimi i Kushteve Për Leje Mjedis të Tipit A

1. Kërkuesi që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “e-Albania”, për pajisjen me leje mjedis të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedis të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7. 2011, “Për lejet e mjedisit”;

c) çdo dokument tjetër i nevojshëm që vërteton deklaratimet në formularin informues, që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

ç) Shfuqizuar;

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga

aksidentet madhore, kur kërkohet;

dh) Relacion rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

...

7. Formati standard i aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit, për lejet e mjedisit të tipit A, është sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

KREU III

Procedurat për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Përcaktimi i Kushteve Për Leje Mjedis Të Tipit B

1. Kërkuesi, që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “e-Albania” për pajisjen me leje mjedis të tipit B, duhet të dorëzojë këto dokumente:

a) Formularin informues për pajisje me leje mjedis të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit";

c) çdo dokument tjetër i nevojshëm, që vërteton deklaratimet në formularin informues që kërkuksi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;

ç) Shfuqizuar.

d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.

dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

...

7. Formati standard i aktit të miratimit dhe i aktit të refuzimit për lejet e mjedisit të tipit B është sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

SHTOJCA 1


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. ____Prot. Datë _____

KËRKESË PËR LEJE MJEDISI
Tipi A

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
Numri i Identifikimit të Kërkesës

Emri i Kërkuksit:

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTi, adresa,) _____
ose
b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....) _____

Për implantin/installimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar) _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolumnës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar) _____
3. Vendndodhja _____

(Qark)
(Bashki)
(Komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar

(Firma, Vula)
Data.....

Tarifa e paguar në datë

☐ për kërkesë për leje mjedisi
☐ ndryshim të kushteve të lejes

SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. ___ Prot.

Data _____

KËRKESË PËR LEJE MJEDISI

Tipi B

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Numri i identifikimit të Kërkesës

Emri i Kërkesës:

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,)

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT, adresa.....)

Për implantin/installimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar) _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar) _____
3. Vendndodhja _____

(Qark)

(Bashki)

(komunë)

Emri, titulli i personit të autorizuar

(Firma, Vula)

Data

Tarifa e paguar në datë

- ☐ për kërkesë për leje mjedisi
☐ ndryshim të kushteve të lejes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI
LEFTER KOKA

Nr. ____Prot.

Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM)

(firma, vula)

Datë _____

AKT MIRATIMI Leje Mjedisi Tipi A

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa)

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT.....)

Për implantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kullonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
3. Vendndodhja _____

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë _____

Tarifa e paguar në datë _____

☐ për kërkesë për leje mjedisi

☐ ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

(emri, mbiemri, firma, vula)

SHTOJCA 5


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

MIRATOHET

MINISTRI
LEFTER KOKA

(firma, vula)

Nr. ____ Prot.
Nr. i identifikimit të Lejes (sipas Regjistrimit të AKM) _____

Datë _____

AKT MIRATIMI
Leje Mjedisi Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,

Pas shqyrtimit të Kërkesës për Leje mjedisi, AKM propozon dhënien e lejes me kushtet bashkëngjitur për Kërkuuesin si më poshtë;

a) Person juridik (Kompania) (Emri tregtar, Nr. NIPTI, adresa,) _____

ose

b) Personi Fizik (emri, mbiemri, Nr NIPT.....) _____

Për impiantin/instalimin:

1. Titulli i instalimit (përshkruaj sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kolumnës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" _____
3. Vendndodhja _____

Vlefshmëria e kësaj Leje dhe kushteve të saj fillon në datë _____

Tarifa e paguar në datë _____

☐ për kërkesë për leje mjedisi

☐ ndryshim të kushteve të lejes

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM
(emri, mbiemri, firma, vula)

III.2.17. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.18. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi dhe konkretisht të pajisjeve si në vijim: “1. *Implant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - copë 1*; 2. *Implant për asgjësimin me incenerim - copë 1 dhe 3. Makineri për larjen e kontenierëve- copë 1*”, ku disponimin e këtyre pajisjeve do ta vërtetojnë duke paraqitur **a.** dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi); **b. të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër**; **c.** katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit implant dhe makinerisë; **d.** deklaratë konformiteti CE i secilit implant dhe makinerisë, si dhe për të siguruar autoritetin kontraktor se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent (referuar procesverbalit të datës 24.03.2026 “*Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim*” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor) ka përcaktuar se këto pajisje duhet të jenë të pasqyruara në Akt Miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 të përcaktuara në shtojcën 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar se në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë ofertues do ta vërtetojnë disponimin e këtyre makinerive nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 10

“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” (pjesë e dokumentave të tenderit), duke përfshirë të dhënat si vijon: *“emërtimi i implantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër)”*, ndërsa në rastin kur operatori ekonomik ofertues kualifikohet i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet që të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të vërtetuar deklaratimet e bëra në Shtojcën 10 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”* të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës.

Ndërkohë nga shqyrtimi i kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 *“Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”* të shtojcës 9/2 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”* të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për metodat apo teknologjitë e trajtimit të mbetjeve spitalore të ndryshme nga metoda e *“Incelarimit”* duhet që të paraqesin Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës dhe Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si në vijim: “18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet dhe 18 01 04 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (psh, veshje, hedhurinat e leokoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj)”, ndërkohë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për metodën apo teknologjinë e trajtimit të mbetjeve spitalore me *“Incelarim”* duhet që të paraqesin Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës dhe Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) që të përfshijë kodin e mbetjeve të rrezikshme si në vijim: “18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”.

Në përfundim të analizës së këtyre kriterëve kualifikuesë, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 *“Kapaciteti teknik”* të shtojcës 9/2 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”* të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor e konsideron të përmbushur këtë kriter kualifikues nga ana e operatorit ekonomikë ofertues të kualifikuar i pari vetëm në rastin se nga ana e këtij të fundit plotësohen 4 (katër) kushte, të cilat janë kumulative dhe konkretisht ky kriter konsiderohet i plotësuar në rastin kur operatori ekonomik ofertues i kualifikuar i para paraqet dokumentacionin si në vijim: “Dokumentacioni që vërteton disponimin e 1 (një) Implant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të 1 (një) Implant për asgjësimin me incenerim dhe të 1 (një) Makineri për larjen e kontenierëve (Kushti i parë); Katalogun apo skedën teknike të Implantit për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të Implantit për asgjësimin me incenerim dhe të Makinerisë për larjen e kontenierëve (Kushti i dytë); Deklaratën e konformitetit të Implantit për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të Implantit për asgjësimin me incenerim dhe të Makinerisë për larjen e kontenierëve (Kushti i tretë), si dhe Akt Miratimin e Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B), Akt Miratimin e Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore), Akt Miratimin e Leje mjedisore të

tipit A (me kod III.1.C) e Akt Miratimin e Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore), ku në këto Akte Miratimi të jetë pasqyruar Impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), të Impianti për asgjësimin me incenerim dhe Makinaria për larjen e kontenerëve (Kushti i katërt).”.

III.2.19. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Medi Tel*” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit nr 69/2026, datë 05.05.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, të parashtruar në pikën III.2 të këtij vendimi, Komisioni konstaton se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë” të shtojcës 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik “*Medi-Tel*” SHPK për metodën dhe teknologjinë e trajtimit të mbetjeve spitalore të ndryshme nga metoda e “Incenerimit” dhe konkretisht për metodën me “Sterilizim (autoklavë)” ka paraqitur në dokumentacionin e ofertës dokumentat si në vijim: “Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisi Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “*Medi Tel*” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.” shoqëruar me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “*Medi-Tel*” SHPK (LC-4073) me aktivitet të licensuar: “Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”.

Përsa i përket kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të shtojcës 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “*Medi-Tel*” SHPK ka dorëzuar Shtojcën 10 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, ku në Seksionin B “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka deklaruar si vijon: “XXX - Primar - Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B)- Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim)- 18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon traitim te veçante per te parandaluar infeksionet;”, ku për metodën e trajtimit të mbetjeve spitalore me “Autoklavim” disponon pajisjen e autoklavimit model “XXX” (pajisje e cila është primare) dhe se për këtë metodë është i pajisur me Leje Mjedisore III 1 B (Tipi B) dhe Licence III 2 B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) (Autoklavim) që përfshin kodet si në vijim: “18 01 01 - Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon traitim te veçante per te parandaluar infeksionet;”, si dhe licencat dhe aktet e miratimit të cituara në pikën III.2.6 të vendimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionin të dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik ofertues “*Medi-Tel*” dhe të cituar në pikën III.2.6 si më sipër, Komisioni konstaton se për përmbushje të deklarimeve të bëra më sipër, ky operator ekonomik ofertues ka paraqitur Leje mjedisi e tipit B, me kodin: III.1.B, me numër: PN-4737-03-2017, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë

“MEDI-TEL” SHPK, shoqëruar me Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, si dhe Licensë me kodin: III.2.B, me numër: LN-9352-11-2019, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë “MEDI-TEL” SHPK, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore.” shoqëruar me Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “MEDI-TEL” SHPK (LC-4073) me aktivitet të licensuar: ‘Grumbullimi, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore’, ku nga shqyrtimi i Akt Miratimi “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit dhe Akt Miratimi “Licensë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “Medi-Tel” SHPK konstatohet se në asnjë rubrikë të këtyre akteve të miratimit nuk është pasqyruar që për metodën e trajtimit të mbetjeve spitalore me “Autoklavim” të jetë e instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “Ecodas T300”, sikurse ka deklaruar ky operator ekonomik ofertues në Shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”.

Për më tepër, referuar korespondencës së Komisionit Prokurimit Publik me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në një rast të ngjashëm me të njëjtat subjekte rezulton se me shkresës nr. 8804/1 prot, datë 20.08.2025, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1944/12 prot, datë 22.08.2025, Komisioni konstaton *aktet e miratimit janë sipas formatit të miratuar me VKM-në Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisit të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", e ndryshuar dhe VKM-së Nr.538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashketa", e ndryshuar, dhe se këto akte përmbajnë përshkrimin e veprimtarisë sipas vetëdeklarimeve të subjekteve, ku në rastin konkret subjekti për të cilin janë miratuar këto akte nuk ka deklaruar llojin, modelin dhe kapacitetin e impiantit për traktimin e metjeve spitalore me metodën “Autoklavim”.* Gjithashtu referuar dhe korespondencës së Komisionit Prokurimit Publik me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për ankesën objekt shqyrtimi rezulton se me shkresës nr. 8925/1 prot, datë 12.06.2026, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, protokolluar me tonën me nr. 1459/4 prot, datë 12.06.2026, rezulton se “Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 1459/3 prot, datë 05.06.2026, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Nr. 8925 prot, datë 08.06.2026, me lëndë “Kërkesë për informacion për subjektin Medi Tel”, ju bëjmë me dije se: Nga verifikimet për subjektin “Medi Tel” me NUIS J71519004Ë, rezultojnë të publikuara në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave pranë QKB-së: - Leje e mjedisit e tipit B, me PN-4737-03-2017, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Asgjësimi I mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2 a), vendi i kryerjes së veprimtarisë; Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zona Kadastrale Nr. 2679, Nr. Pronësie 41/1/16/2 me Akt Miratimi Nr. 2959 Prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11, ku janë të pasqyruara të gjitha të dhënat e instalimit, për veprimtrainë, proceset, metodat dhe kapacitetin. - Licensë e nënkategorisë me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë; Grumbullim, transportim, ruajtje,

trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, vendi i kryerjes së veprimtarisë: Tiranë, Autostrada Tiranë Durrës, Km.1, Rruga Vidhëgjatë, Ndërtesa Nr. 18, Zonë Kadastrale Nr. 2679, Nr. pronësisë 41/1/16/2, me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45, ku janë të pasqyruara lloji i mbetjeve për grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim deri në asgjësim. Bashkëlidhur shkresës gjeni kopje të lejes së mjedisit me PN-4737-03-2017, Akt Miratimi Nr. 2959 prot, datë 13.04.2018, Nr. i identifikimit të lejes 2533/1, K.Nr.11 dhe Licencës me kod III.2.B, me LN-9352-11-2019 me Akt Miratimi Nr. 793 prot, datë 29.10.2025, Nr. i identifikimit 367/1, K.Nr.45.

Përsa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, argumentimit të kriterit kualifikues dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi “Medi Tel” SHPK, për vërtetimin e kriterit kualifikues, Komisioni gjykon se ky i fundit nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në Akt Miratimin “Leje Mjedisit Tipi B” nr. 2533/1, datë 13.04.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit dhe në Akt Miratimi “Licencë e kategorisë III.2.B” nr. 367/1, datë 29.10.2025, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Medisit, për subjektin “Medi Tel” SHPK nuk evidentohet se për metodën e trajtimit të metjeve spitalore me “Autoklavim” në këto akte të jetë e pasqyruar që ky subjekt ka të instaluar impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “ECODAS T300”, duke mos plotësuar kushtin e katër kumulativ të përmendur në pikën III.2.15 të këtij vendimi dhe për më tepër në përgjigjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A referuar shkresës nr. 1431/8 prot., datë 05.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1275/3 prot., datë 07.05.2026 ku evidenton si në vijim: “Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, “Medi-Tel” shpk konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur dokumentacionin që zotëron mjetet e kërkuara, të dhënat teknike si dhe pasqyrimin e tyre në aktet e miratimeve të lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për lejet dhe licensat”, nuk evedentohet se në cilën rubrikë të akt miratimeve të sipërpërmendura është pasqyruar instalimi i impianti për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) i modelit “Ecodas T300”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79831-03-24-2026, me objekt “Evadim mbetje spitalore për DSR Dibër 2026”, me fond limit 6,486,240 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e finances, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

